



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Kryesia e Kuvendit

P-007

Prishtinë, më 23 nëntor 2017, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 23 NËNTOR 2017

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Aida Dërguti, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Mufera Sinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Glauk Konjufca, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Caktimi i datës për vazhdimin e seancën plenare

Kryetari i njoftoi të pranishmit se në seancën plenare, të filluar sot më 23 nëntor 2017, është përfunduar vetëm pika e parë e rendit të ditës - Koha për deklarime jashtë rendit të ditës, ndërsa pikat e tjera kanë mbetur pa u shqyrtua.

Ai propozoi që seanca plenare t'i vazhdojë punimet të premten, më 24 nëntor 2017.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me caktimin e datës për vazhdimin e seancës plenare.

Nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti, propozoi seanca plenare t'i vazhdojë punimet të mërkurën, më 29 nëntor 2017.

Lidhur me propozimet e lartshënuara për caktimin e datës për vazhdimin e seancë plenare diskutuan: Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; dhe Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia, me shumicë votash, (3 “për” dhe 2 “kundër”- Aida Dërguti dhe Kujtim Shala), vendosi që seanca plenare e Kuvendit t'i vazhdojë punimet të premten, më 24 nëntor 2017, në orën 10:00.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 14:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale